



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 10
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 22 prill 2015, në orën 13:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, kryetare e Komisionit, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi, anëtarë.

Mungoi: Adem Hoxha.

Të ftuar: Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë, Curr Gjocaj, drejtor i SHSKUK, Arsim Qavderbasha, Arianit Jakupi, Xhevat Ukaj dhe Musa Rexhaj.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.4.2015;
3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Imet Rrahmani dhe me drejtorin e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës z. Curr Gjocaj; Temë diskutimi: Çështja e pronës së Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës – SHSKUK si dhe objekteve rreth saj;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më: 15.4. 2015;

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më: 15.04 2015, pa vërejtje.

3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Imet Rrahmani dhe me drejtorin e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës z. Curr Gjocaj. Temë diskutimi: Çështja e pronës së Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës – SHSKUK si dhe objekteve rreth saj.

Kryetarja – Siç jemi pajtuar në mbledhjen e kaluar, sot të ftuar në Komision e kemi ministrin e Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani dhe drejtorin e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, z. Curr Gjocaj si dhe bashkëpunëtorët e tyre. Fillimisht falënderoj ministrin, drejtorin si dhe pjesëmarrësit e tjerë, të cilët ju kanë përgjigjur pozitivisht ftesës sonë.

Pra sot do të diskutojmë rreth çështjes së pronës së Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës si dhe objekteve rreth saj. Në opinion po diskutohet se Qendra Klinike Universitare, përditë e më shumë po e humb pronën , duke ju shpronësuar pjesë të caktuara të pronës së saj. Natyrisht kjo çështje u aktualizua për shkak të diskutimeve në opinion se një spital privat është ndërtuar në pronë të Qendrës Klinike Universitare dhe se së shpejti pritet që të fillojë punën, megjithatë ne kemi edhe disa informacione se aty ka shtëpi, lokale dhe objekte tjera. Andaj në kemi shprehur gatishmërinë që drejtpërdrejt të dëgjojmë nga ministri i Shëndetësisë dhe drejtori i Qendrës Klinike Universitare, lidhur me këtë çështje.

Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë, duke marrë fjalën tha se kjo temë është ngritur shumë herë dhe është diskutuar edhe në opinion. Po ashtu është diskutuar edhe brenda Ministrisë, rreth mundësisë se keqmenaxhimit të pronës publike, respektivisht të pronës të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Natyrisht, në gjerat konkrete nuk do të thellohem, pasi që këtu me ne është edhe drejtori i Qendrës Klinike Universitare dhe sigurisht është më mirë i informuar lidhur me këtë çështje. Po them, që në këtë moment, prona e Qendrës Klinike Universitare është duke u matur nga zyrtarët e Gjeodezisë së Komunës së Prishtinës me kërkesën e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor të Kosovës dhe sigurisht pas kësaj matjeje, do të dihet saktë se a kemi të bëjmë me uzurpim, qoftë nga personat privatë, qoftë nga subjektet tjera. Kurse sa i përket spitalit apo objektit që është duke u ndërtuar, ekziston një vendim i Komunës së Prishtinës, i cili i ka mundësuar që përmes një kontrate të lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe një investitori, të jepet në shfrytëzim si huadhënie. Për detaje të tjera besoj se drejtori është këtu dhe mund të na informojë më saktë, por për momentin janë duke u bërë matjet e pronës dhe tek atëherë mund të dimë se a kemi uzurpime. Nëse ka, kush janë ata dhe sa është dëmtuar prona e Qendrës Klinike Universitare?

Curr Gjocaj tha se Shërbimi Spitalor Klinik Universitar si shërbim i ri, pra që nga viti kaluar ka filluar funksionimin e tij sipas Ligjit për Shëndetësi dhe që në fillim të mandatit tim si drejtor veprimin e parë që e kemi bërë, të cilin njëherësh e kemi edhe obligim ligjor sipas statutit, ka qenë regjistrimi i të gjitha aseteve, të paluajtshme dhe të luajtshme, jo vetëm të QKUK-së po për të gjitha institucionet në varësi të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, pra SHSKUK-së dhe për këtë ju kemi adresuar të gjitha institucioneve kompetente si në nivel qendror, ashtu edhe atë lokal, ku i kemi institucionet spitalore ose institucionet tjera dhe në këtë rast edhe për pronat e mjekësisë QKUK-së, Qendra Klinike Spitalore Universitare, ku operojnë

edhe institucione tjera brenda asaj hapësirë siç janë: Qendra Stomatologjike, Transfuzioni i Gjakut, Agjencia për Produkte dhe Pajisje Mjekësore dhe me këtë ndarje të re apo pavarësim të këtyre institucioneve ne duhet në këtë rast mes nesh të përcaktojmë kufijtë e secilit institucion, por për ne fillimisht me rëndësi është përcaktimi i saktë i kufijve të jashtëm të pronës, se sa pronë kemi dhe ku i kemi kufijtë dhe mbi të gjitha a kemi ndonjë uzurpim të mundshëm, siç po flitet në opinion brenda kufijve të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Tash për tash i kemi disa shënime të cilat janë me të vjetra, ku sipas tyre QKUK-ja duhet t'i ketë 37.77 hektarë, nga 41.33 hektarë, të cilët kanë qenë ma herët dhe në bazë të një përgjigjeje të Komunës, janë identifikuar edhe 6 parcela, të cilat janë dhëne në shfrytëzim për çështje tjera dhe në kuadër të këtyre parcelave në vitin 2006 në shfrytëzim për qiradhënie i është dhëne Spitalit për Kardiologji, pra spitalin privat për të cilin kohëve të fundit është folur në opinion. Ky spital privat, sipas këtyre shënimeve ka në shfrytëzim parcelën në sipërfaqe rreth 1.5 hektar, pra në total 41.33 hektarë rezulton se QKUK-ja duhet ti ketë kufijtë e jashtëm, pra në shfrytëzim një sipërfaqe prej 37.77 hektarë.

Ne shpresojmë se shumë shpejt do të kemi të dhëna të sakta, ku pas një takimi që kemi pasur me kryetarin e komunës së Prishtinës, ekipet e saj kanë filluar matjet e pronës dhe besojmë se do t'i kemi dokumentet shumë shpejt, ku do të dimë saktë se cilët janë kufijtë dhe cila është sipërfaqja e Qendrës Klinike Universitare si dhe a kemi ndonjë uzurpim të pronës brenda kësaj hapësire dhe vetëm atëherë mund të diskutojmë lidhur me këtë çështje, pra se a ka apo nuk ka uzurpim të pronës.

Një çështje tjetër të cilën e kemi zgjidhur me Komunën, është te hyrja kryesore që e kemi pasur problem me kufirin ku lidhet me institutet paraklinike ka qenë hyrja e morgut nga jashtë, ku kjo kërkohet me standarde dhe me mirëkuptim të kryetarit sot është liruar ajo rrugë dhe do të rregullohet hyrja dhe do të ketë qasjen e veçantë, pra në këtë pjesë janë të përcaktuar qartë kufijtë e pronës.

Kryetarija – Pra të jemi të qartë, ju keni bërë kërkesë në Komunë për përcaktim të qartë të kufijve të pronës së Qendrës Klinike Universitare dhe jeni duke pritur nga ta që t'i bëjnë matjet dhe pas kësaj t'i keni dokumentet dhe informatat e sakta sa i përket sipërfaqes dhe uzurpimeve të mundshme.

Curr Gjocaj – Po, ashtu është. Ne kemi kërkuar matjen dhe përcaktimin e kufijve apo gjendjes faktike të tërë sipërfaqes apo pronës së Qendrës Klinike Universitare. Pra ky është obligim ligjor yni, pasi që ne brenda një viti jemi të obliguar që Qeverisë t'ja prezantojmë gjendjen faktike me të gjitha asetet që i ka në posedim Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës.

Time Kadrijaj – Pra, siç e dini rreth kësaj teme është bërë shumë zhurmë edhe më herët si nga komisionet parlamentare, po ashtu edhe nga Sindikata e Shëndetësisë edhe në media. Vetë fakti që prezantoi drejtori se kemi dy dokumente, ku në njërin dokument thuhet se prona është diku 41.33 hektarë dhe në tjetrin diku 37.77 hektarë, po dokumentohet se afërsisht 4 hektar janë apo mund të jenë të uzurpuar, pra ju përgëzoj për iniciativën që e keni marrë për përcaktimin e qartë të kufijve të pronës së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Pra, mua po me intereson të dijë se pas përfundimit të matjeve nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës të Komunës së Prishtinës, pra pas kësaj do të dihen saktë kufijtë e pronës së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në rast se evidentohen se ka uzurpim të pronës, a do të zbatoni këtë vendim dhe cilat masa do ti merrni ju si ministri dhe ju si drejtor i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës ndaj këtyre uzurpatoreve ?

Curr Gjocaj – Vetëm për saktësim 41.33 hektarë është sipërfaqja totale e Qendrës Klinike Universitare dhe këtë sipërfaqe janë duke e shfrytëzuar edhe disa institucione, si fjala vjen

Agjencia për Pajisje dhe Produkte Mjekësore, që ka në shfrytëzim 0.38 hektar kurse Instituti i Mjekësisë Ligjore i shfrytëzon 0.80 hektar, ndërsa një sipërfaqe prej 0.20 është në shfrytëzim nga motrat e nderit, pra nga kjo, sipërfaqja e cila është momentalisht në dispozicion apo e shfrytëzueshme jo vetëm nga Qendra Klinike Universitare, por edhe nga institucionet tjera është sipërfaqja prej rreth 37.77 hektarë.

Imet Rrahmani - Pas matjeve që do të bëhen dhe nëse konstatohet se kemi uzurpim të pronës, ne do t'i procedojmë tek organet kompetente dhe kjo është më se e sigurt dhe njëherësh e kemi obligim që ne si Ministri e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar në këtë rast si pronar të këtyre hapësirave të iniciojë procedurën e lirimit të hapësirave të saj dhe kjo varet prej organeve tjera se sa mund të bëjnë lirimin e këtyre hapësirave. Sa na përket neve, ju garantojmë se ne do të procedojmë sipas ligjit kërkesën për kthim nëse vërtetohet se kemi uzurpim të pronës.

Besa Baftiu - Sa i përket pronësisë së SHSKUK-së apo Shërbimit Spitalor Klinik Universitar dhe qendrave të tjera, mua me vjen mirë në këtë rast se drejtori paska kërkuar nga Komuna e Prishtinës respektivisht prej gjeodezisë që të përcaktojë pronën e Qendrës Klinike Universitare. Siç e dimë është bërë një bujë e madhe lidhur me atë se sa është uzurpuar apo se sa po keqpërdoret prona e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar, qoftë këtu qoftë në qendrat apo komunat tjera, mirëpo në bazë të kësaj që tha drejtori janë diku afërsisht 41.33 hektarë. Ne kemi informata se në bazë të asaj që Sindikata e Shëndetësisë ka dalë dhe pse po besoj se nuk janë të vërteta pasi që as këto të dhëna që i prezantuat nuk janë të sakta, pasi që pritet që gjeodezia të jep raportin e fundit.

Kemi informacione se ka uzurpime. Ajo çka po me intereson mua është uzurpimi i paligjshëm që i është dhënë Spitalit Amerikan në afërsi të pronës së Qendrës Klinike Universitare, ku e dimë që ka pas shkelje qysh në dhënien e tenderit të asaj pronë e dihet se nga komuna e Prishtinës në vitin 2003, nga kryeshefi ekzekutiv i asaj kohe, pra pa tenderim i është dhënë kjo pronë personit në fjalë dhe e dimë që është dhënë për Qendrën Klinike Universitare, mirëpo është dhënë për kardiokirurgji tani ne me sa e dimë sipas ministrit dhe programin qeverisës që kemi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të kësaj qeverie, ministri ka theksuar shumë herë se kardiokirurgjia do të funksionalizohet dhe do të jetë prioritet i këtij mandati qeverisës.

Më intereson të dijë se çka keni ndërmarrë ju lidhur me këtë pronë apo spitalin amerikan, i cili është aty i kundërligjshëm dhe se ju e dini se komuna e ka dhënë lejen, mirëpo ju jeni pronari i kësaj pronë pra SHSKUK-ja është pronare. Andaj a keni ndërmarrë ju ndonjë veprim lidhur me këtë projekte në afërsi të Qendrës Klinike Universitare?

Imet Rrahmani –Çështja e këtij objekti, i cili po pretendohet se do të shndërrohet në spital të përgjithshëm është diskutuar edhe më herët në mbledhje të komisionit. Marrëveshja për huadhënie të shfrytëzimit të asaj pronë në sipërfaqe prej 1.5 hektar, është lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe dr. Fatmir Dalladakut për hapjen e spitalit të kardiokirurgjisë. Kjo marrëveshje është lidhur pra në dhjetor të vitit 2005. Marrëveshja është 10 vjeçare e dhënë me disa kushte. Natyrisht sipas dokumenteve që i kemi, kushtet e marrëveshjes nuk janë zbatuar ose janë prishur dhe unë besoj që Komuna e Prishtinës duhet të iniciojë shkëputjen e kontratës me dr. Dalladakun ose të iniciojë procedurë pse është transferuar huamarrja tek një subjekt tjetër. Ministria e Shëndetësisë është duke analizuar situatën shumë komplekse që është krijuar pasi që tash Spitali Amerikan i cili funksionon në Hajvali ka një licencë të veprimtarisë, diku deri në vitin 2016 dhe ka parashtuar një kërkesë për zhvendosje në atë objekt, kështu

Çështja e kësaj pronë e dhënë në shfrytëzim si huadhënie, esoj se Komuna e Prishtinës i ka marrë disa hapa për sqarimin e këtij problemi.

Besa Baftiu –Sindikata e mjekëve dhe sindikata e punëtorëve shëndetësorë kanë dal kundër uzurpimit të pronës së SHSKUK-së, mirëpo njëherësh edhe drejtoret e klinikave janë kundër uzurpimit të pronës publike. Ju si drejtor menaxhues çka mund të na thoni, a jeni kundër uzurpimit të këtyre pronave nga spitalet private?

Curr Gjocaj – Ju faleminderit deputete. Secili nga ne e kemi për detyrë si zyrtarë publik mbrojtjen e pronës publike sepse na obligon detyra, por siç e kemi edhe për obligim për t'i respektuar edhe vendimet të cilat në këtë rast së paku deri në momentin që po flasim janë legjitime sepse ajo pronë është dhënë në shfrytëzim nga organi shtetëror sipas një procedure, e cila ka kaluar në Kuvendin Komunal dhe sigurisht që janë dokumentet deri kur mundet me u shfrytëzua ose se si mundet me u shfrytëzua. Tash kur po flasim, ai nuk është aset sepse është dhënë me qira dhe do të shohim se kur do të skadojë afati, pra ne jemi me mbrojtje të pronës, jo vetëm në Qendrën Klinike Universitare por në të gjitha institucionet tjera shëndetësore.

Hatim Baxhaku - Mendoj se nuk është çështja vetëm e pronës se në fund të fundit pas 10 viteve apo pas përfundimit të afatit, ajo do ti kthehet në pronësi të SHSKUK-së. Problemi është se a lejohet dhe se sa do të lejohet hapja e spitaleve private brenda hapësirave të pronës së SHSKUK-së, pra problemi ma i madh do të lindë me vonë lidhur me konkurrencën në dhënien e shërbimeve në SHSKUK, ku pastaj mund të dalin telashe të mëdha dhe mund të ndikojë shumë negativisht në zhvillimin e SHSKUK-së, dhe sidomos kur do të fillojë funksionimi i fondit për sigurimet shëndetësore. Në këso raste mund të lindin problemet ma të mëdha në lidhjen e kontratave për ofrimin e shërbimeve sepse këto institucionet private sigurisht mund të kenë edhe kushte ma të mira sa i përket kushteve të infrastrukturës. Dua të di nga ju se cili është qëndrimi i juaj lidhur me mundësinë e hapjes së spitaleve private, qoftë brenda ndërtesave të SHSKUK-së, qoftë brenda hapësirës apo pronës së SHSKUK-së? Këtu duhet të jeni shumë të qartë. Gjërat se sa është e kundërligjshme të mos lejohet dhe sa është e ligjshme të lejohet dhe se sa dëmtohet Shërbimi Spitalor Klinik Universitar.

Imet Rrahmani – Pajtohem me deputetin. Shpresojmë se me instalimin e një konkurrence të mirëfilltë në mes të institucioneve publike dhe private dhe brenda institucioneve publike si njësi, ne do të kemi mundësi që të ofrojmë shërbime me të mira shëndetësore pra shërbime me cilësore dhe kjo neve nuk duhet të na frikësojë si Ministri e Shëndetësisë. Vetëm konkurrenca mund të rritë cilësinë. Fundja, qytetarët e Kosovës janë të interesuar që të marrin shërbime shëndetësore cilësorë brenda Kosovës. Jemi në vazhdimësi duke bërë përpjekje që të shtojmë gamën e shërbimeve shëndetësore që do ofrojë sistemi publik shëndetësor, që do t'ju ofrojë qytetarëve të Kosovës. Në këtë kontekst mund të paralajmëroj sinqerisht se viti 2015, do të jetë viti ku kardiokirurgjia dhe kardiologjia invazive do të funksionalizohen dhe do të jenë konkurrues të denjë të çdo aktiviteti privat në Kosovë. Kjo po na kushton shumë në buxhet, pos kësaj ne duhet të kemi parasysh se po punohet intenzivisht në ngritjen e fondit për sigurimet shëndetësore, atëherë menaxherët, respektivisht bordi që do të menaxhojë me fondin dhe njësitë që do të kontraktjnë shërbimet shëndetësore, do të kenë kujdes që të kontraktjnë vetëm ato që ofrojnë cilësi. Unë jam shumë i sigurt se në rrethana të tilla çfarë gjendemi apo sigurisht për pak vite largësia e institucioneve publike dhe atyre private nuk do të jetë determinues i konkurrencës, por do të jetë determinuese cilësia, e cila do të ofrohet brenda këtyre institucioneve shëndetësore. Unë e kam thënë edhe kohë me parë dhe po e rtheqsoj se potenciali profesional është brenda institucioneve publike shëndetësore dhe profesionistët me të mirë janë të punësuar me orar të plotë në institucionet publike, ndërsa bëjnë punë shtesë në institucionet private, kështu që nuk duhet të kemi hamendje se institucionet publike do të dëmtohen nga institucionet private për shkak të afërsisë pasi që potenciali ekziston brenda institucioneve publike.

Njomza Emini –Ndoshta sa i përket pronës unë pajtohem me kolegun tim këtu, ndoshta ne më shumë duhet të fokusohemi tek kriteret, në këtë rast spitali amerikan që do të hapet në afërsi të Qendrës Klinike Universitare. Pra pyetja ime është konkrete, spitali amerikan a ka licencë dhe me çfarë kriteresh është licencuar nëse ka licencë ?

Imet Rrahmani – Ne e theksuam se leja për ushtrim të veprimtarisë ju ka dhënë për shfrytëzim të hapësirave për kardiokirurgji kurse tendenca është që aty do të hapet spital i përgjithshëm. Ka një licence që është e vlefshme deri në fund të vitit 2016, kurse kriteret janë si për çdo spital tjetër privat që duhet t'i plotësojë, pra i nënshtrohet procesit të licencimit si çdo institucion tjetër privat.

Shfrytëzoj rastin që t'ju informoj se ne këto ditë do të udhëtojmë për në Emiratet e Bashkuara, ku do të nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi për ndërtimin e spitalit për Kardiokirurgji Pediatrie, pra një investim komplet donacion i Emirateve të Bashkuara Arabe. Dhe do të vlerësojmë ish- pediatriinë se a ka mundësi që ato hapësira të shndërrohen apo të destinohen për një spital të përgjithshëm të Prishtinës, pra po theksoj se do ta vlerësojmë, nuk po them se do ta bëjmë. Spital i cili do të shkarkoj Qendrën Klinike Universitare dhe do të krijoj hapësira për shërbime me cilësorë. Ne si ministri do të jemi të kujdesshëm se hapja e spitaleve të tilla private të jenë komplementare me nevojat e sistemit shëndetësor dhe është mirë që të mos bëjmë investime të dyfishta, pra është mirë që investimet private t'i këshillojmë se këto janë nevojat për sistemin shëndetësor në Kosovë dhe ju këtu mund të na ndihmoni me investimet e juaja.

Në këtë fazë ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm, kur kemi humbje të besimit të investitorëve të huaj, ne të pengojmë investimet e huaja në Kosovë, qofshin ato në shëndetësi, qoftë në sferat tjera.

Besa Baftiu – U tha se spitali amerikan e ka lejen dhe e ka licencën për punë, por ky spital ka leje dhe licencë të punojë në objektin ku është duke punuar, ndërsa spitali i ndërtuar brenda Qendrës Klinike Universitare, është dhënë në shfrytëzim për kardiokirurgji e jo për spital të përgjithshëm. Tani çka do të ndërmerrni si ministri në këtë drejtim, pasi spitali është dhënë për spital të kardiokirurgjisë, është dhënë në mënyrë jo të drejt dhe pa proces të tenderimit. Ky spital ka qenë i paraparë për kardiokirurgji e ka licencë për vendin ku po punon si spital i përgjithshëm, çka do të ndërmerrni që ta pengoni pasi thatë se kardiokirurgjia do të hapet së shpejti në kuadër të SHSKUK-së dhe nuk është e nevojshme të kemi një spital të tillë.

Imet Rrahmani – Qeveria e Kosovës në vitin 2009 ka marr një vendim, që ka shfuqizuar dy vendimet e mëhershme të Qeverisë, për moslejimin e ndërtimit të këtij spitali, dhe ka lejuar ndërtimin e atij objekti. Hapja ose moshapja e atij spitali, apo shndërrimi i atij objekti në spital do të merret në Qeveri. Pasi Qeveria të marrë një vendim, nëse e lejon hapjen e atij spitali atëherë Ministria e Shëndetësisë do të fillon procedurën për licencim .

Besa Baftiu – Desha të pyes edhe për „Farmedin”, pasi kemi informacione se ai objekt është privatizuar dhe nuk do të punojë më si „ Farmed” por do të punojë ndonjë veprimtari tjetër komerciale. Gjithashtu edhe parkingu në afërsi të QKUKS-së, çka do të ndërmerrni ju si Ministri dhe si drejtori nëse këto nuk punojnë për çka janë të destinuara dhe ju ndërrohet destinimi ?

Curr Gjocaj – Sipas dokumenteve kadastrale, që nga viti 1996, „Farmedi” nuk është pronë e QKUK- së, ndërsa sa i përket çështjes së parkingjeve, deri tani kemi pas kontratë me koncesion dhe janë shfrytëzuar parkingjet nga një operator privat, ndërsa nga 15 prilli e kemi ne, në shfrytëzim, dhe jemi duke menaxhuar me resurset tona.

Time Kadrijaj – A është në fuqi ende urdhëresa administrative për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë private shëndetësore në distancë 1.5 kilometra nga spitalet publike ?

Imet Rrahmani –Ai udhëzim nuk është shfuqizuar ende, ai shfuqizohet me fuqizimin e udhëzimit të ri, dhe udhëzimi nuk është hartuar ende. Në hartimin e atij udhëzimi do të angazhohet edhe sindikata.

Shukrije Bytyçi – Sa objekte private janë brenda pronës së QKUK- së, dhe cilat janë veprimtaritë e tyre, pasi u tha se ka edhe shtëpi banimi, dhe çka do të ndërmerrni ju në atë drejtim?

Curr Gjocaj – Duke iu referuar dokumenteve që posedojmë, ato objekte të banimit nuk janë në pronësi të QKUK- së dhe ky incizimi i ri i situatës ka filluar aty, ndërsa sa i përket objekteve tjera që zhvillojnë veprimtari aty, kemi një qoshk në shfrytëzim nga një operator privat, një qoshk që shfrytëzohet nga PTK-ja dhe një bankomat të një banke komerciale, me të cilat kemi marrëveshje. Të tjerat mendojmë se nuk janë në hapësirat tona, por të presim rezultatet.

Shukrije Bytyçi – Pra do të presim të njoftohemi pasi të bëhet incizimi i pronës, dhe vërtet të dimë se cila është vërtet prona e QKUK së.

Fadik Beka – Ka edhe një incizim i cili është bërë në vitin 2006, nga shërbimi i gjeodezisë dhe i kadastrës së Komunës së Prishtinës .

Curr Gjocaj tha se ne kemi regjistrin zyrtar të Komunës, që është bërë në vitin 2010, por ka edhe regjistrime më të hershme. Nuk duam të ngrisim pretendime pa u bërë matjet e sakta, dhe ne do ta mbrojmë pronën tonë.

Kryetarja - Falënderoj ministrin dhe drejtorin për informacionet që dhanë, dhe besoj kjo çështje do të përfundojë pasi të marrim gjendjen e re kadastrale nga Komuna e Prishtinës.

Time Kadrijaj – Desha të ngrit një çështje më shumë të bashkëpunimit, dhe kërkoj që të kemi një bashkëpunim më të mirë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe kur të organizohen tryeza ose takime për të shënuar evenimente të shëndetësisë, të ftohen edhe deputetët, e sidomos anëtarët e Komisionit.

Fikrim Damik – Jemi të interesuar të informohemi edhe për fillimin e zbatimit të Ligjit për sigurime shëndetësore, pasi kemi informata edhe për fondet e dhëna nga Banka Botërore për zbatim të këtij ligji.

Imet Rrahmani – Një nga prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë është hyrja në fuqi e Ligjit për Sigurime Shëndetësore. Kemi bërë një analizë të detajuar dhe kemi pa se ende nuk jemi gati për të filluar me sigurime shëndetësore dhe një nga top prioritetet e Ministrisë është edhe hartimi i udhëzimeve administrative, i rregullores së AFSH-së , hartimi i çmimoreve, nisja e mbledhjes së premie dhe fillimi i dhënies së shërbimit. Kemi deklaruar që gjatë vitit 2015, nuk do të mund të fillojmë me mbledhjen e premie. Marrëveshja me BB-në na ndihmon shumë që ne të jemi të përgatitur më mirë për fillimin e mbledhjes së premie. BB-ja është e gatshme të na ndihmojë edhe në aspektin teknik, ndërsa edhe Qeveria ka ndarë grandin prej 10 milionëve , por ka mbet edhe shumë të bëhet që kjo të fillojë.

Duhet të kemi parasysh se cilat janë grupet që do të lirohen nga pagesa e premieeve, pasi kemi shumë kategori sociale. Duhet të punojmë edhe në sistemin e informimit shëndetësor dhe në hartimin e çmimoreve reale për shërbimet spitalore dhe jospitalore. Duhet të punojmë edhe për grupet që do të fillojmë t'i rimbursojmë barnat. Me marrëveshjen me BB-në kemi edhe një grand që do tu jepet komunave për performancë të mirë në shëndetin primar.

Flora Brovina – Kemi marr pjesë në mënyrë intensive në miratimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore dhe mezi po presim të fillojë të zbatohet. E dimë se pa këtë ligj është shumë vështirë të realizojmë reformat shëndetësore.

Fikrim Damka – Interesimi ynë është se a ka ndoshta nevojë që Ligji të ndryshohet në ndonjë çështje që ka vështirësi në zbatim?

Arsim Qavderbasha – Falënderoj për interesimin tuaj dhe unë do ju referohem dy çështjeve ; një është zbatimi i Ligjit për sigurime shëndetësore , ndërsa projekti i BB-së ka të bëjë me përkrahjen në procesin e krijimit të institucioneve për zbatimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore. Sa i përket Ligjit të sigurimeve shëndetësore, ka disa çështje që janë shumë urgjente dhe që duhet vepruar. Kemi filluar me funksionalizimin e Agjencisë, kemi dërguar rregulloren për aprovim në Qeveri. Një nga çështjet kyçe është sistemi i informimit i FSSH-së, i cili është një sistem i ndarë nga SISH-i i shëndetësisë, por janë shumë të ndërlidhura me njëri-tjetrin. Roli i sistemit të informimit të FSSH-së është i madh sepse duhet të informojë të gjitha institucionet shëndetësore 24 orë, se a e ka pacienti të paguar sigurimin shëndetësor apo duhet të paguaj.

Jemi në bashkëpunim me disa projekte për të fituar në kohë dhe në çmim sa i përket këtij sistemi të informimit dhe në projekt është angazhuar një kompani shumë serioze austriake. Çështje tjetër është çështja e trajnimeve të master trajnerëve, të cilët do të vazhdojnë procesin e trajnimeve në të gjitha institucionet shëndetësore, e që do të realizohet me fondet e Bankës Botërore.

Pika tjetër është ndërtimi i bazës ligjore, ku është duke u punuar në disa udhëzime administrative njëkohësisht. Jemi duke punuar edhe në listën e kujdesit themelor shëndetësor. Kemi punuar edhe pakon e shërbimeve shëndetësore, ku çdo shërbim në pjesën spitalore e ka listën e çmimeve dhe e kemi përgatitur sipas modelit maqedonas me modifikime dhe e kemi krijuar çmimoren që quhet DRG. Me këto ne duhet të jemi në harmoni me vendet evropiane sepse DRG-ja duhet të raportohet për çdo pacient. Çmimorja do të jetë për shërbimin spitalor dhe jashtë spitalor. Çmimorja do të kompletohet edhe me çmimin që do ta paguaj vet pacienti, çmimin që do ta paguajnë personat e pasiguruar dhe çmimorja për të huajt .

Është duke u punuar në udhëzimin administrativ për mbledhjen e premieeve. Jemi duke punuar edhe në udhëzimin administrativ për pagesat dhe bashkëpagesat, si dhe në udhëzimin administrativ për qytetarët e liruar nga bashkëfinancimi i shërbimeve shëndetësore. Ne duhet ta kemi të saktë se kush me të vërtet lirohet nga pagesa e premiumit dhe e bashkëfinancimit.

Sa i përket amendamentimit të Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore, mendoj se vendimi i Qeverisë për uljen e pragut të kompanive dhe pagesës së TVSH-së, nga 50 mijë euro, në 30 mijë euro, ka ndikuar edhe në Ligjin e Sigurimeve Shëndetësore, ku pragu prej 50 mijë euro duhet të ulet edhe në Ligjin e Sigurimeve.

Kryetarja – Komisioni është i gatshëm që të përkrah amendamentimin e Ligjit, që ligji të funksionalizohet. Në funksion të zbatimit të këtij ligji është edhe funksionalizimi sa më parë i odave të profesionistëve shëndetësorë.

Kisha një pyetje edhe për kategoritë e punëtorëve të rrezikuar në punë, si policët, zjarrfikësit, doganierët dhe shërbimet tjera, çfarë është ndërmarrë për mbulimin e tyre?

Besa Baftiu – Pyetja ime është për Sistemin e Informimit Shëndetësor, sepse të gjithë e dimë se është shumë i rëndësishëm për funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore. Në vitin 2009 është dhënë një donacion milionësh nga Qeveria e Luksemburgut për funksionalizimin e SISH-it, çfarë është bërë në atë drejtim dhe ku kanë përfunduar këto mjete, e nuk është funksionalizuar SISH-i?

Imet Rrahmani – Sa i përket grupeve të punëtorëve të rrezikuar në punë, kjo nuk është e rregulluar. Ndoshta më vonë do të rregullohet. Sa i përket SISH-it, drejtorët e pranishëm do t'ju informojnë më hollësisht.

Xhevat Ukaj – Qëndroj fuqishëm pas mendimit se SISH-i e ka një fillim, por nuk ka fund sepse vazhdimisht duhet të transformohet. Lëvizje pozitive në SISH kanë filluar në vitin 2011. Kemi një strategji të SISH-it 2010- 2020, e cila është hartuar nga ekspertët e Komisionit Evropian dhe është aprovuar në vitin 2011. Kosto e kësaj strategjie është 17 milionë euro, do të thotë me buxhetin vjetor prej 1 milion euro, na duhen 17 vjet për ta përfunduar.

Duke u nis prej faktit se SISH-i, është prioritet i Qeverisë, shpresojmë se me rishikimin buxhetor do të sigurojmë buxhet që ta implementojmë SISH-in deri në vitin 2018. Kemi mbështetje shumë të fuqishme të Qeverisë së Luksemburgut. Ju informoj se faza e parë e projektit të SISH-it ka përfshirë shtrirjen e harduerit në regjionin pilot. Regjioni pilot përfshin 30% të territorit të Kosovës, ku janë komplet Regjioni i Prizrenit me shëndetin primare dhe sekondar, dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Gjithashtu përfshin kujdesin parësor vetëm brenda qytetit të Prishtinës. Faza e parë e pilot projektit ka përfshirë vetëm shtrirjen e rrjetit. Ky projekt ka pas kosto rreth 1.6 milion euro, ku 1.2 milion i ka dhënë Qeveria e Luksemburgut, ndërsa Ministria i ka dhënë rreth 400 mijë euro.

Projekt tjetër që është në realizim e sipër është projekti i softuerit. Sipas planit, pilot projekti pritet të përfundojë në shtator të vitit 2015. Me projektin e ri që është duke u përgatit me Qeverinë e Luksemburgut, do të vazhdohet mbulimi edhe i pjesës tjetër me rrjet. Projekti i digjitalizimit të shëndetësisë është projekt shumë kompleks dhe ka shumë sfida.

Para dy muajve kemi ngrit një trup ndërministror, i cili do të koordinojë aktivitetet në mes aktorëve që marrin pjesë në implementimin e projektit të SISH-it.

3. Të ndryshme.

Kryetarja – Për pikën, të ndryshme ju informoj se nga takimi që kam pasur me KDI-në, ka rezultuar gatishmëria e tyre të bashkëpunojnë me Komisionin në fushën e hulumtimeve. Unë kam menduar që në bazë të këtij bashkëpunimi KDI-ja t'i realizojnë tri hulumtime për Komisionin tonë : një për Këshillin Ekonomiko Social , pastaj për Ligjin për Shëndetësinë dhe tjetri për shëndetin oral. A keni ju ndonjë propozim tjetër apo këto mjaftojnë sa për fillim?

Mendova se këto tri tema janë të rëndësishme sepse jemi duke monitoruar Ligjin për KES-in dhe e pamë se ka probleme. Gjithashtu kemi pas diskutime për largesën e institucioneve private shëndetësore nga ato publike dhe kjo ka të bëjë me Ligjin e Shëndetësisë. Gjithashtu nga diskutimi që patëm me ekspertë, sa i përket shëndetit oral, e pamë se doli si i nevojshëm edhe hartimi i një plani kombëtar.

Njomza Emini –Pajtohem plotësisht me bashkëpunimin me KDI-në , dhe se hulumtimet do të na ndihmojnë në punën tonë. Gjithashtu jam për punimin e një plani kombëtar për shëndetin oral.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që përmes Drejtorisë për Hulumtime të Kuvendit të Kosovës të kërkohet nga KDI-ja, realizimi i këtyre tri hulumtimeve:

Funksionimi i Këshillit Ekonomiko Social në regjion;

Ligji i Shëndetësisë në shtetet e regjionit dhe në BE;

Shëndeti oral .

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA